BASHKIA MALIQ

EKONOMIA PYJORE DHE KULLOSORE

“Zëmblak-Mali i Thatë”

PLANI I MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

PËR

PERIUDHËN 2021 – 2031

BASHKIA MALIQ

EKONOMIA PYJORE DHE KULLOSORE

"Zemblak – Mal i Thate"

PLANI I MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR

PERIUDHËN 2021 – 2031

KODI SISP

Financuar:	Banka Boterore
Kontraktuar:	Ministria e Turizmit Dhe Mjedisit
Kompania Fituese:	Abkons dhe Oikon Croatia.
Drejtuesi projekti:	Blerina Kurti
Drejtues Teknik	Ing. Pyjesh Abdullah Diku Ing Pyjesh Vasillaq Mine
Pergatitja e Projektit:	Shtator 2021
Vleshmeria E Perdorimit:	Per Periudhen 10 Vjecare (2021- 2031)

Abkons
Rr, Themistokli Gërmenji Nr,6 Kat 2
Tirane Shqipëri
Email: Info@abkons.com
Tel+35542258326
www.abkons.com

Miratuar më datë _____

MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MINISTRI

Nr. 6770/2 prot. Datë 4.10.2022

URDHËR

Nr. 299, datë 4.10.2022

"PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE "MALIQ-LOZHAN", "MESMAL", "MOGLICË", "PIRG-MOÇAN", "BOFJE E DUSHARIT", "ZEMBLAK-MALI I THATË" DHE "STRELCË", BASHKIA MALIQ"

Në mbështetje të shkronjës "dh" të nenit 59, pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, shkronjës (b), pika 2, neni 11, të ligjit nr.57/2020, datë 30.4.2020, "Për Pyjet", pas vlerësimit nga struktura përgjegjëse për pyjet në ministri se planet e mbarështimit të ekonomive pyjore "Maliq-Lozhan", "Mesmal", "Moglicë", "Pirg-Moçan", "Bofje e Dusharit", "Zëmblak-Mali i Thatë" dhe "Strelcë", dërguar me shkresën nr.4647, datë 13.9.2022, të bashkisë Maliq, është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore nga ekspertë të certifikuar për pyjet, bazuar në "Manualin e Planeve të Mbarështrimit të Pyjeve e Kullotave",

URDHËROJ:

1. Miratimin e planeve të mbarështimit bashkëlidhur këtij urdhëri, i cili është pjesë përbërëse e tij, për ekonomitë pyjore "Maliq-Lozhan", "Mesmal", "Moglicë", "Pirg-Moçan", "Bofje e Dusharit", "Zëmblak-Mali i Thatë" dhe "Strelcë", në pronësi publike të bashkisë Maliq. Planet e mbarështimit kanë afat vlefshmërie 10-vjet.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë Maliq, të bëjë përditësimet përkatëse në regjistrin e fondit pyjor dhe hedhjen e të dhënave në sistemin "ALFIS".

3. Ngarkohen struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë Maliq dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, për zbatimin e këtij urdhëri

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 3043 **Prot** **Maliq, më 28 . 05 .2021**

VENDIM
Nr. 37 datë 28 . 05 .2021

Për miratimin paraprak të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Maliq.

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*"i ndryshuar datë 17.12.2015 neni 8,9, pika 1, nënpika 1.1, germa (b), neni 55 pika 2 dhe 6, neni 64 "*Kopetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë" pika (c)*; Ligji 57/2020 "Për Pyjet"; Ligj nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"; Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*" i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 398 datë 13.05.2020 "*Për disa ndryshime në vendimin nr 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave*"; Manualit të planeve të mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave Janar 2019; Shkresës nr. 2507 prot datë 04.05.2021 nga kompania abkons "*Për planet e mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave*", Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planet e Mbarështimit të Bashkisë Maliq.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

BASHKIA MA...
Z... Prot...
Nr. 3343/2 Pr...
Date 22-6-2021 ...krimi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 499/2 Prot. Korçë, më 14.06.2021

Lënda: *Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit*

KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ

Mbështetur në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të vendimeve nr.29, nr.30, nr.31, nr.32, nr.33, nr.34, nr.35, nr.36, nr.37, datë 28.05.2021 të Këshillit të Bashkisë Maliq, ***konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre,*** bazuar në nenin 3, 8, 9, 24, 29, 54, 55, 64, 66/ë të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.100, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2021", në ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384, datë 12.6.2019 " Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", në vendimin nr.361, datë 29.5.2019 "Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes sëindividëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, nërastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.522, datë 25.7.2019 "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 15.4.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.272, datë 16.05.2018 "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Kombinati i sheqerit", SH.a, Maliq, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Maliq", në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 31.01.2020 "Për miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Maliq", në vkb nr.122, datë 26.11.2018 "Për ndryshim destinacioni për strehim dhe përdorim për banesa sociale të godinës ekzistuese jo banimi te ish-laboratori, pjesë e Kombinatit të sheqerit Maliq", në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", në vkb nr.100, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2021", në udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 25.01.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", në udhëzimin nr.22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve të administratës të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, në vendimin nr.99, datë 24.12.2020 "Për miratimin e numrit të punonjësve , nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të saj për vitin 2021", në nenin 9/5, 11, 30 gërma a të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", në ligjin nr.57/2020 "Për pyjet", në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

PREFEKTI
Dhori Spirollari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Adresa: L. 7 Rr. "28 Nëntori" Tel. 08224 2953 . e-mail: Prefekti.Korce@mb.gov.al

PERMBAJTJA E PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE EKONOMISE PYJORE ZËMBLAK-MALI I THATË

1. HYRJE

1.1. Qellimi dhe objektivat e planit tembareshtrimit te pyjeve dhe kullotave,
1.2. Ecuria e punes dhe punes dhe pergjegjesite
1.3. Metodologjia e punes
1.4. Informacioni i perdorur ne hartimin e PMPK

2. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISE PYJORE

2.1. Informacion i pergjithshem rreth ekonomisepyjore
2.2. Pronesia, administrimi, organizimi
2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative
2.4. Konteksti i bashkise dhe ekonomisepyjore
2.5. Historiku i mbareshtrimit tepyjeve dhe kullotave neekonominepyjore
2.6. Situata demografike dhe social ekonomike
2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore
2.8. Gjuetia dhe peshkimi
2.9. Fasilitetetrekreacionale dhe didaktike
2.10. Prania e zonave te mbrojtura, specieve dhe stacioneve

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1. Mbareshtrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave
3.1.1. Perdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)
3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore ne parcela dhe nenparcela
3.1.4. Ndarja e pyjeve

4. KUSHTET STACIONALE

4.1. Klima
4.2. Topografia dhe morfologjia
4.3. Gjeologjia
4.4. Tokat
4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me uje
4.6. Erozioni ne shpate dhe rrjedhiet ujore
4.7. Rreshqitjet

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

5.1. Brezat bioklimatike
5.2. Pyjet dhe kullotat
5.3. Tipet e pyjeve

5.4. Tipet e kullotave
5.5. Tipet potenciale te vegjetacionit
5.6. Biodiversiteti
5.7. Prania e vlerave konservuese te larta (VKL)
5.8. Rreziqet perbiodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin
5.9. Mundesiteper aktivitetet didaktike dhe kerkim shkencori

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

6.1. Analiza e tedhenaveper Pyjet
6.1.1. Analiza e tipeve te pyjeve
6.1.2. Shperndarja e siperfaqes dhe volumit sipas formes se qeverisjes
6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave temoshes dhe klasave te prodhimit
6.2. Analiza e tedhenave te kullotave
6.2.1. Gjendja e kullotave
6.2.2. Madhesia e siperfaqes se kullotave dhe vendodhja e tyre
6.2.3. Altituda, pjerresia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike
6.2.4. Mbrritshmeria
6.2.5. Grumbullimi i te dhenaveper zonat e djegura ne kullota(10 vitet e fundit)

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

7.1. Rezultatet e Inventarizimit te Pyjeve
7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit
7.2.2. Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore
7.2.3. Struktura Vertikale
7.2.4. Cilesia e materialit drusor
7.2.5. Biomasa dhe faktoret e ekspansionit te biomases
7.2.6. Analiza e rolit te ekonomise pyjore ne sekuestrimin e karbonit
7.2. Gjendja shendetsore dhe fitosanitare
7.2.1. Druret e thare
7.2.2. Demtimet e tjera
7.3. Prerjet e paligjshme
7.3.1. Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne proçesin e planifikimit
7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale ne planifikimin dhe mbareshtrimin e pyjeve
7.4. Rezultatet e inventarizimit te kullotave
7.4.1. Tipi dhe cilesia e kullotave
7.4.2. Perdoruesit e kullotave dhe koha
7.4.3. Llojet e bagetive
7.4.4. Perdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtes i kullotave
7.4.5. Infrastruktura aktuale
7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorise me baze ushqimore

7.4.7 Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore

8. OBJEKTIVAT E MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1. Objektivat e pergjithshmeper planifikimin afat-gjate

8.2. Objektivat kombetareperzhvillimin e pyjeve dhe kullotave pajtueshmeria e PMPK me planifikimin rajonal dhe ate ne nivel Bashkie

8.3. Objektivat kryesore te PMPK

8.4. Objektivat specifike teekonomise pyjore/NJM

8.5. Objektivat specifike mbi perdorimin e tokes, funksionin dhe formen e qeverisjes

8.5.1. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

8.5.2. Objektivat specifik silvikulturale

8.5.3. Objektivat specifik per kullotat

8.5.4. Objektivat specifik mbi biodiversitetin

8.5.5. Objektivat specifik mbi gjendjen shendetsore

8.5.6. Objektivat specifik mbi faunen

8.5.7. Objektivat specifik per pyjet me funksion prodhues

8.5.8. Objektivat specifik per pyjet me funksion mbrojtes

8.5.8. Objektivat specifik per pyjet me funksion rekreacioni

8.5.9. Objektivat specifik per pyjet me funksion konservues

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NE KUADER TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundesia vjetore e shfrytezimit

9.2. Prerja vjetore silvikulturore

9.3. Planifikimi vjetor i masave

9.3.1. Masat ne pyje

9.3.2. Masat ne kullota

9.3.3. Masat neinfrastrukture,ne zonat e degraduara,rekreacionale dhe didaktike

9.4. Masat afat-gjata

9.4.1. Masat silvikulturale netrungishte

9.4.2. Masat silvikulturore ne cungishte

9.4.3. Masat silvikulturore ne shkurre

9.4.4. Pyllezimi, ripyllezimi

9.4.5. Masat ne kullota

9.4.6. Gjendja dhe masat neinfrastrukturen e ekonomise pyjore

9.4.7. Masat specifike per aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

10. VLERESIMI EKONOMIK

10.1. Vleresimi i efekteve te masave te planifikuara ne pyje dhe kullota

10.2. Planifikimi i te ardhurave/perfitimeve

10.3. Planifikimi i kostove/shpenzimeve

10.4. Analiza kosto-perfitim

11. LIDHJA MIDIS PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP

12. PROÇESI I VALIDIMIT TE PMPK NE SISP

13. MIRATIMI I PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

14. MONITORIMI I ZBATIMIT TE PMPK

15. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TE PLANIT TE MBARESHTRIMIT

16. RISHIKIMI AFAT-MESEM I PLANIT TE MBARESHTRIMIT

17. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TE MBARESHTRIMIT

18. PERGATITJA E HARTAVE

- Hyrje.
- Harta e ekonomise pyjore
- Harta e funksioneve
- Harta e tipeve te pyjeve dhe kullotave
- Harta e rrjetit rrugor, infrastuktures dhe zonave te degraduara
- Harta e nderhyrjeve

Permbledhje ekzekutive

Plani i Mbarështrimit të Ekonomisë pyjore "Zëmblak – Mali Thatë" u realizua nga "Abkons" sh.p.k mbeshtetur ne manualin e mbareshtrimit ne fuqi dhe ka vlefshmeri perdorimi per nje periudhe prej 10 vjetesh (2021-2031).

Plani i Mbarështrimit të Ekonomisë pyjore "Zëmblak – Mali Thatë" synon që të merren ne konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre: popullata lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli,interesi qe ofron kullota, blegtorët etj., pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve, plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.

Gjithashtu vend të veçantë zë përfshirja e interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, harmonizimi i këtyre interesave në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të kullotave dhe pyjeve.

Ekonomia pyjore ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 2707.425 ha dhe sipas perdorimit te teritorit ka kete strukture :

- pyll	**669.7 ha**
- sip. me bim. Pyjore(shkurre)	1113.4 ha
- sip. bujqesore	3431.814 ha
- kullote – livadh	923.3 ha
- urbane	199.258 ha
- ujore	5.123 ha
- djerr (eroduar) jo produktive	7.472 ha
- Rrugë	49.236 ha

Pyjet me funksion mbrojtes zene 927.3 ha ose 100% te siperfaqes pyjore.

Funksioni kryesor	**Aktual**		**I propozuar**	
	Ha	***%***	***Ha***	***%***
Prodhues	855.82	48	855.82	48
Mbrojtes	927.305	52	927.305	52
Konservim	0	0	0	0
Rekreacion	0	0	0	0
Total	**1783.125**	**100**	**1783.125**	**100**

Tipet e pyjeve qe perbejne masivet pyjore te ekonomise jane:

- Formacione me pyje ahu zene 407.942 ha 22.9 % te siperfaqes pyjore.
- Formacione me pyje pishe e zeze 207.193 ha ose 11.6 % te siperfaqes pyjore.
- Formacione me pyje shkoze 219.8 ha ose 12.3 % te siperfaqes pyjore.
- Formacione me pyje dushqe dhe shkurre te tjere zene 948.19 ha ose 53.2 % te siperfaqes.

Fuqia lendore ne kembe e pyjeve te ekonomise eshte 21552.5 m^3, kurse vellimi mesatar i pyjeve te ekonomise per ha eshte – rreth 32 m^3.
Per çuarjen e grumbujve drejt normalitetit jane propozuar masa konkrete ne drejtim te:

- Nderhyrja me punime permiresuese.
- Perdorimit optimal te stacionit.
- Sigurimit te gjenerates se re ne rruge natyrore.
- Ruajtjes te biodiversitetit te flores e faunes.
- Mbrojtjes te pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit te infrastructures rrugore.
- Krijimit te tregut te punes.
- Perfshirjes te popullsise lokale e te pushtetit vendor ne vendimmarrjet kryesore per mbareshtrim te qendrueshem te ekonomise pyjore.
- Permiresimit te gjendjes reale dhe perkujdesjes per pyjet.

Pyjet me funksion mbrojtes do te jete 52% nga siperfaqja e kesaj ekonomie me një sipërfaqe prej 927.305 ha.
Punimet silvikulturore qe duhen kryer per te çuar grumbujt e ekonomise drejt normalitetit per periudhen ne vazhdim konsistojne ne:

- kryerjen e pastrimeve ne 16.144 ha siperfaqe
- kryerjen e rrallimeve komerciale ne 28.722 ha
- kryerjen e pyllezime me pishë të zezë ne 0.419 ha

Detyrat kryesore per 10 vjeçarin e ardhshem ne zbatim te ketij Plani Mbareshtrimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverise Shqiptare per zhvillimin te sektorit te pyjeve e kullotave ne harmoni te plote me programet e Bashkise Maliq.

Harta e vendndodhjes së ekonomisë Pyjore "ZËMBLAK-MALI I THATË"



1.HYRJE

1.1. Qellimi dhe objektivat e Planit te Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave

Ekonomia pyjore "Zëmblak – Mali Thatë", është inventarizuar për herë të fundit në vitin 1985, pra para 36 viteve dhe është hartuar bazuar ne manualin përkatës, nën drejtimin e ish Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave.

Gjatë kësaj periudhe e cila përfshin edhe tranzicionin që po kalon shoqëria jonë, gjithashtu edhe kjo ekonomi pyjore ka pësuar ndryshime të ndjeshme dhe mjaft të mëdha, përsa i përket strukturës, ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit, sipas klasave të moshës dhe prodhimit, si rrjedhoje e aktivitetit njerëzor.

Nisur nga fakti që plani aktual i inventarizimit është shumë i vjetër dhe nuk pasqyron realitetin, ishte e domosdoshme hartimi i planit të ri të mbarështrimit, i cili pasqyron gjendjen reale të grumbujve pyjorë të kësaj ekonomie.

Në objektivat e këtij plani mbarështrimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar "sigurimi i një mbarështrimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve dhe kullotave te kesaj ekonomie".

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore "Zëmblak – Mali Thatë".

Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit Axess, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

1.2.Ecuria e punes dhe pergjegjesite

Fillimisht është kryer puna përgatitore për sigurimin e bazës materiale, si instrumentet e ndryshëm, dokumentacionin e nevojshëm, si planin e inventarizimit aktual, hartat topografike e parcelave, përgatitjen e formularëve për punimet e terrenit, Aplikacionit Zana etj.

Faza tjetër lidhet me punimet e terrenit, për ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë dhe marrjen e të dhënave të nevojshme.

Pas përfundimit të punimeve të terrenit, u bë përpunimi i të dhënave me program kompjuterik, u përgatitën hartat dixhitale të gjendjes dhe të punimeve, si dhe hartimi i raportit te planit të mbarështrimit.

Qe ne fazën e punës përgatitore si dhe gjate kohës se punimeve te terrenit dhe përgatitjes se planit te mbarështrimit, ka patur një bashkëpunim te vazhdueshëm me specialistet e Drejtorisë të Pyjeve ne Bashkine Maliq, te cilët kane ndihmuar ne ecurinë dhe përcaktimin e objektivave të planit të mbarështrimit.

1.3 Metodologjia e Punes.

2 Punimet e terrenit dhe ato te zyrës janë kryer në bazë të kërkesave të udhëzuesit përkatës. Kufijtë e vjetër brenda ekonomisë janë ruajtur për ndarjen e parcelave, ndërsa në ndarjen e

n/parcelave ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e gjendjes aktuale të çdo parcele.Gjithashtu nga ana tjetër, janë pasqyruar kufijtë reale te secilës parcelë, ne funksion te shtrirjes aktuale te vegjetacionit.

3 Inventarizimi me sipërfaqe provë është bërë duke zbatuar kriteret e përcaktuar.

4 Madhësia e sipërfaqeve provë varion nga 25 m^2 (r = 2.82 m) do te shërbeje për matjen e rigjenerimit, drurëve me diametër bazimetrik(1.3 m nga toka) nga 2.0 - 7.5 cm, vlerësimin e produkteve jo-drusore dhe inventarizimin e kullotave , sipërfaqja e dyte rrethore me madhësi 200 m2 (r = 7.98 m) do shërbeje për matjen e drurëve me diametër bazimetrik nga 7.51 deri 27.5 cm, dhe sipërfaqja e jashtme rrethore me madhësi 400 m2(r = 11.28 m) do te shërbejë për te matur drurët me diametër bazimetrik > 27.5 cm.

1.4 Informacioni i perdorur ne hartimin e PMPK

Si baze për hartimin e planit te mbarështrimit te ekonomisë pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë", kane shërbyer dokumentacioni ekzistues, i disponuar nga DShP Korçë dhe sektori pyjor përkatës.

Materialet bazë të përdorura për hartimin e planit të mbarështrimi kanë qenë:

- Plani/inventarizimi i vjetër i ekonomisë.
- hartat e ekonomisë, me ndarjet ne ngastra e n/ngastra, te gjendjes dhe te punimeve
- hartat topografike në shkallë 1:25000,
- ortofoto (imazhe) satelitore,
- pasqyrat dendrometrike për llojet kryesore pyjore,
- informacione te ndryshëm te sektorit pyjor.

1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISE

2.1 Informacion i pergjithshem rreth Ekonomise pyjore

Ekonomia Pyjore "Zëmblak – Mali Thatë"shtrihet ne shpatin jugor te malit te thate, duke përfshirë te gjithë luginen e Cangonjit dhe deri ne shpatin verior te malit qe ndodhet ne Zemblak.

Kjo ekonomi e ka marre emrin nga fshati Zemblak dhe Mali Thate, qe ndodhen ne skain Jugor dhe Verior te kesaj Ekonomie.

Në Bashkinë Maliq, funksionojnë gjithsej 7 Njësi të qeverisjes Vendore, nga të cilat: 1 Njësi Bashkiake Qyteti Maliq dhe 6 Njësi Administrative rurale. Njësitë Administrative gëzojnë statusin e përcaktuar me Ligj.

Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore "Zëmblak – Mali Thatë", me periudhë vlefshmërie 2021 deri 2031, bëhet për herë të parë, pas të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Zemblak dhe Zvezde dhe ekonomise kullosore Mali i Thate, viti 1985 dhe viti 1992, si pjesë e kësaj Ekonomie Pyjore.

Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, tjetërsime të disa pjesë të n/ngastrave në pemëtore e toka bujqësore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar "Manuali i planeve të mbarështimit te pyjeve dhe kullotave", janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore "Zemblak –Mali i Thate" rezultoi 2713.869 ha. Për këto arsye, ishte urgjente hartimi i këtij

Plani të ri Mbarështrimi, me synim menaxhim të qëndrueshëm, qeverisje e trajtim të pyjeve, dhe plotësim të gjithë funksioneve të tyre.
Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore "Zemblak –Mali i Thate". Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.
Është bërë rivlerësimi i n/parcelave, sipas programit Access, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

2.2. Pronesia, administrimi dhe organizimi

Bazuar në të dhënat mbi pyjet e kullotat e zonës, rezulton se para vitit 1945 fondi pyjor dhe kullosor ka qenë i ndarë sipas fshatrave me kufij të qartë midis tyre. Fshati i ka patur të ndarë pyjet dhe kullotat mbi baze fisi apo familje. Kujdesi për pyjet e fshatit ka qene i mire, prandaj grumbujt pyjorë ishin në gjendje zhvillimi të kënaqshëm.
Pyjet shfrytëzoheshin nga komuniteti duke respektuar disa rregulla teknike të vendosura bashkërisht. Kjo edhe për kullotat. Kush prishte këto rregulla gjobitej nga kryepleqësia e fshatit. Pas vitit 1945 u bë shtetëzimi i pyjeve dhe kullotave si kudo në vendin tonë. Kjo ndikoi në një farë mase edhe në dëmtimin e ekonomisë pyjore. Kemi konstatuar se banoret e zonave perkatese diskutojnë rrallë mbi gjendjen e pyjeve dhe masat qe duhen mare për përmirësimin e tyre.
Pas vitit 1960 te drejtën e përdorimit ligjor e kishte vetëm shteti. Fshataret i siguronin drutë dhe lenden sipas planit. Shfrytëzimet e pyjeve bëheshin nga ndërmarrjet shtetërore dhe pas vitit 1990 nga firmat private te licencuara, sipas rregullave teknike. Por prerjet e paligjshme kanë dëmtuar shumë sipërfaqet pyjore fletore por edhe halore, duke favorizuar edhe dukurinë e erozionit në faqet e pjerrëta. Një konstatim që vlen të theksohet është edhe fakti se ne disa pjese ngastrash të cilat ndodhen afër shtëpive të banimit që janë ruajtur, gjendja dhe përvoja duhet përkrahur dhe përgjithësuar nga të gjitha pjesët e Ekonomisë. Ka ekzistuar dhe në të kaluarën, por edhe sot pjesëmarrja e gruas në punimet në pyje dhe në vjeljen e prodhimeve pyjore, bimët mjekësore eterovajore (bimët), etj.

2.3 Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore "Zemblak –Mali i Thate" ndodhte në Lindje te qendres te Bashkise maliq dhe bën pjesë në territorin e Njesise Administrative Pojan , Bashkia Maliq.

Ka kufi te qarte natyrale, te tille si maja, kurrize,qafa,perrenj,etj..

Ajo kufizohet:

- Ne jug me territorin e Bashkisë Korçë dhe Bashkise Devoll.
- Ne lindje me Parkun Kombetar te Prespes dhe Njesine Administrative Proger Bashkia Devoll.
- Ne veri me Parkun Kombetar te Prespes
- Ne perëndim me tokat bujqesore te fshtarve Podgorie,Vreshtas,Pojan, Zvezdë, etj...

Të dhënat e koordinatave, X, Y, Z, janë marrë me GPS në terren, si dhe nga hartat, e ortofotot e gjeoreferuara, sipas Sistemi i Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP)), Përgatitja e hartave u realizua në sistemin GIS duke respektuar standartet, si dhe bazuar në sistemin e ri zyrtar KRGJSH.
Hartat topografike dhe ortofotot janë marrë sipas ASIG (www.asig.gov.al).
Sipërfaqja e ekonomisë pyjore sipas mbarështrimit të tanishëm është 2713.869 ha , nga e cila 1783.125 ha janë sipërfaqe pyjore (Trungishte, Cungishte, Shkurre) , 923.3 ha jane kullota dhe rreth 7.4 ha janë sipërfaqe jo pyjore (Joprodhuese,shtrat Lumi,). Të gjitha kategoritë e sipërfaqeve janë të inkuadruar në përshkrim me 60 parcela dhe 138 nën parcela.

2.4 Konteksi i Bashkise dhe Ekonomise Pyjore

Në territorin e Bashkisë Maliq, Pyjet dhe kullotat, menaxhohen respektivisht në 7 Ekonomi Pyjore dhe Kullosore, për të cilat, janë duke u hartuar Planet e Mbarështimit. Në afërsi të Ekonomisë Pyjore "Zëmblak - Mali i Thatë" nuk ndodhen Ekonomi Pyjore te tjera te cilat administrohen nga Bashkia Maliq.
Sipas pozicionit Gjeografik të Ekonomisë në studim, preken nga kjo Ekonomi Pyjore fshatrat e Njësisë Administrative Pojan,respektivisht fshatrat: Podgorie,Bregas,Gurbardhe,Zvezde, Burimas,Zemblak.
Plani i Mbarështrimit, përpunimi i të dhënave të marra në terren jep një pasqyrë të qartë të gjendjes dhe konsistencës së pyjeve përmes sipërfaqes, tipit të grumbujve pyjorë dhe të përdorimit të territorit dhe veçanërisht të strukturës së pronësisë rëndom të pa formalizuar . Grupet e punës gjatë gjithë kohës ishin në kontakt me komunitetin që banon dhe kryen veprimtarinë e tij lidhur me mjedisin pyjor e kullosor duke i përfshirë në problematikat dhe trajtimin e tyre në planifikim.

2.5 Historiku i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave ne Ekonomine Pyjore

Bazuar në mbarështrimin e vitit 1985 Ekonomia Pyjore dhe Kullosore "Zemblak-Mali Thate" ka qenë si në tabelën nr. 2.5.1;

Të dhënat kryesore sipas mbarështrimit të vitit 1985,

Përdorimi i territorit	**Sasia ha**	**%**
Trungishte	194.0	18.6
Cungishte	519.3	49.8
Shkurre	328.0	31.6
Total	1041.3	

(tabela nr.2.5.1)

Bazuar në mbarështrimin e tanishëm Ekonomia Pyjore dhe Kullosore "Zëmblak-Mali i Thatë" paraqitet si në pasqyrën nr. 2.5.2;

Të dhënat kryesore sipas mbarështrimit 2021,

Përdorimi i territorit	**Sasia ha**	**%**
Pyll	669.7	24.7
Shkurre	1113.4	41
Kullote	923.2	34
Te tjera	7.5	0.27
Total	2713.869	

(tabela nr.2.5.2)

Shtesat në trungishte vijnë si rezultat i pyllëzimeve artificial të viteve ’90, shtesat në shkurre vijnë si rezultat i instalimit të shkurreve në sipërfaqet jo prodhuese dhe ato me bimësi pyjore.

Në mbarështrimin e vitit 1985 funksioni i pyjeve ka qenë prodhues (1041.3 ha funksion prodhues) , ndërsa me mbarështrimin e ri kemi përcaktimin si në tabelën nr.2.5.3;

Pyje prodhues 855.82 ha

Pyje mbrojtes 923.27 ha

(tabela nr.2.5.3)

2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike

Në Ekonominë Pyjore “Zëmblak-Mali i Thatë” bëjnë pjesë gjithsej 7 fshatra, të Njesise Administrtive Pojan dhe Vreshtas.

Në këto fshatra banojnë rreth 13730 banorë si më poshtë vijon, (*shih tabelën nr. 2.6.1.*)

TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Tabela nr.2.6.1.

Nr.	Fshati	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Krahë pune
1	Podgorie	4230	2052	2178	3679
2	Bregas	1650	811	839	1120
3	Shengjergj	820	411	409	692
4	Zvezde	2360	1177	1183	1878
5	Burimas	1040	519	521	758
6	Zemblak	1800	900	900	1413
7	Plase	1830	914	916	1183

Duke krahasuar numrin aktual të popullsisë me atë të para disa viteve do të konstatohet se ka një rënie, prej rreth 0.2%.

Punësimi në sektorin shtetëror dhe në atë privat është i pakët. Ka mjaft forca pune në emigracion . Punonjësit e tjerë te afte për pune merren me aktivitete bujqësore e blegtorale,

pranë minifermave të tyre. Zhvillime ka marrë pemëtaria, e orientuar kryesisht me peme frutore, por edhe vreshtari.

Ka shumë familje që trajtohen me ndihme ekonomike nga shteti.
Nga pemëtaria dhe vreshtat ka filluar te sigurohen te ardhura te kenaqeshme.
Blegtoria dhe sigurimi i bazës ushqimore
Në këto Njësi Administrative mbarështohen rreth 11115 dhen, 3150 dhi, 3070 lopë dhe 540 njëthundrakë. Numri i dhive shënon një rënie në krahasim me disa vjet më parë, tregues ky pozitiv për ri ngritjen e pyjeve të lisit, shih tabelën nr. 3.6.3,

tabela nr. 3.6.3.

Nr.	Fshati	Lloji i blegtorisë (krerë)				Prodhimi (kv)	
		Dhen	Dhi	Gjedh	Një thundrake	Qumësht	Mish
1	Podgorie	6000	1000	600	97	13635	790
2	Bregas	1200	500	500	85	11875	319
3	Shengjergj	420	175	210	40	220	270
4	Zvezde	1190	500	600	108	600	770
5	Burimas	510	215	260	46	330	860
6	Zemblak	920	390	460	84	590	1550
7	Plase	875	370	440	80	570	1470
Total		11115	3150	3070	540	27820	6029

Sektori i blegtorisë zë një peshë të rëndësishme në ekonominë e zonës. Baldushku përmendet si mbarështrues i lopës dhe me pak i te imtave. Tendenca është që në të ardhmen numri i dhive te vijë duke u pakësuar sepse dëmton pyllin dhe nuk ka të ardhme të kënaqshme.
Baza ushqimore e bagëtive sigurohet nga mbjellja e foragjereve dhe bari i grumbulluar nga livadhet te cilat janë te pakta.

2.7. Marketinguiproduktevepyjoredrusoredhejodrusore

Historikisht brenda Ekonomisë Pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë", janë prodhuar dru zjarri, degë për voze, por me e rendesishme edhe perdorimi i kullotes per blegtorine e zones. Komuniteti i zonës ka grumbulluar edhe bimë mjekësore e tanifere. Prodhimet nga pylli, sidomos dru zjarri e lëndë ndërtimi, janë realizuar nga subjekte të licencuar, dhe janë grumbulluar e magazinuar në sheshe depozitimi. Nuk ka pasur kantiere, sektor etj. Niveli i kualifikimit të personelit ka qenë i mirë, po ashtu edhe mekanizimi i punimeve në pyje.
Sipërfaqja dhe vëllimi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;

	Viti 1985	**Viti 2021**
• Pyje gjithsej	713.3 ha;	669.7 ha,
• Volumi i përgjithshëm	10133 m^3,	21552.5 m^3,
• Lëndë punimi	1024 m^3,	0 m^3
• Dru zjarri	9109 m^3.	20229.4 m^3



Viti 1992 Viti 2021

Shenim: Levizja duke krahasuar vitet ka ndodhur edhe per shkak te ndarjes te fondit pyjor e kullosor sipas ndarjes Administrative te territorit.

2.8. Gjuetia dhe peshkimi

Ne ekonominë pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë" gjenden lloje të ndryshme kafshësh dhe shpendësh të egra siç mund të përmendim dhelprën, lepurin e egër, ujkun, derri i egër, ariu etj. Ndër shpendët përmendim thëllëzën e malit, pëllumbin e egër, qukapiku etj.

Gjahu i egër është gjuajtur duke mos respektuar ligjin ne fuqi per gjuetine dhe rregullat përkatëse. Gjithashtu, presioni i njeriut mbi pyllin, ka ndikuar në pakësimin gradual të faunës së egër dhe deri në zhdukjen e disa llojeve.

Me qenë se gjuetia është një e ardhur e mire për ekonominë e fshatit, duhet të merren masa që të organizohet mirë puna për mbarështimin e saj.

Ligji aktual i Moratoriumit të Gjuetisë ka sjellë ndikim në mbrojtjen e faunës së zonës. Nuk ka të dhëna mbi kadastrën e gjuetisë bazuar në studime e azhornime.

Peshkimi per banoret e zones nuk ka paraqitur interes.

2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike

Ne territorin e ekonomise pyjore Zëmblak-Mali i Thatë nuk ka akoma struktura te mirefillta per zhvillimin e turizmit. Gjithashtu krijohet mundesia e organizimit te vizitave ne terren per peisazhin natyror liqenor dhe zhvillimin e pylltarise dhe shume aspekte te tjera zhvillimore.

Deri me tani nuk ka ndonje guide turistike per ecjet ne terrene malore apo gara me bicikleta, gjithashtu nuk ekziston asnje skice apo harte me shtigjet dhe rrugicat per kembesoret. Ne kete zone mund te krijohen shume mire mundesite per zhvillimin e turizmit natyror duke shtuar shtepite e pritjes per turistet vendas dhe te huaj.

Zhvillimi i turizmit natyror ne pyjet dhe fshtrat e zones eshte nje mundesi punesimi per banoret e zones si dhe perdorimi i vlerave te burimeve natyrore.

Deri tani nuk ka te dhena per numrin e turisteve as per te punesuarit ne kete fushe te aktivitetit njerzor. Vizitoret e zones jane me se shumti njerez qe shfrytezojne lidhjet e tyre shoqerore dhe miqesore dhe akoma nuk quhen turist.

2.10. Prania e zonave te mbrojtura, specieve dhe stacioneve

Ne ekonomine pyjore Zëmblak-Mali i Thatë, jane vendosur pakashume kufizime ne ato pjese te territorit, qe do te trajtohen me funksion mbrojtes me mundesi prodhimi, pyjet privat, publik, biotopet e habitatet e veçante per te cilat eshte propozuar mbrojtje strikte nga kullota dhe prerjet si dhe jane propozuar masa te veçanta trajtimi ne te ardhmen.

Nga biotopet do te veçonim: Shoqerimet pyjore natyrore P N – ne te gjithe nengastrat e ekonomise. Shoqerime pyjore te rralla pothuajse nuk ka, perjashtuar pjesen tek ish sektori i shfrytezimit qe eshte future ne menyre artificiale bredhi me riperteritje me fare, ku verehen ekzemplare te rralle te ketij lloji.

Ne habitatet e veçanta do tepermendim :

- Habitatet e perrenjve me Parnasia palustris, Caltha palustris, Pinguikula hirtiflora etj. Qe ndodhen vetem ne nje siperfaqe te kufizuar tek burimet ujore dhe liqeni.
- Habitatetmonofitike me Equisetum telmateia, Eracleumspondilium, Epilobium hirsutumetj. qehasen ne afersiteburimevenatyroredheliqeneve e ligatinave.

Gjithashtukufizime ne nderhyrje do te kete edhe ne brezin e pyjeve qe jane ne kreshta dhe ekstremin e vegjetacionit.

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1 Mbareshtrimi dhe funksionet e pyjeve djhe kullotave

Ekonomia pyjore Zëmblak-Mali i Thatë regjistron nje mbareshtrim fillestar te vitit 1985 dhe me i fundit I vitit 2021.

- Kufijte e ekonomise pyjore ne te dy rastet e para jane pothuajse te njellojte me perjashtim te ndonje ndryshimi qe nuk paraqet interes te veçante. Kurse ne mbareshtrimin e trete kemi ndryshim te kufijeve sepse kemi dhe ndryshim te administrimit te territorit. Tani ky territor administrohet nga bashkia Maliq.
- Mbareshtrimet e fundit jane realizuar nga stafe te specializuar ne keto punime, kane ruajtur pothuajse te njejtat konture te ekonomise, te cilat jane te qarta dhe natyrore.

3.1.1. Perdorimi i territorit (aktual & propozimet)

Siperfaqja e ekonomise sipas perdorimit te territorit (tokes) jepet ne pasqyren me poshte. Ndryshimet e siperfaqes sipas destinacionit nga mbareshtrimi aktual me ate te propozuar komentohen si me poshte:

- Siperfaqja pyjore aktuale eshte 3281.341 ha. Kullota e livadhe 460.284 hadhe joproduktive 151.248 ha. Nuk ka ndryshime te theksuara ne perdorimin e territorit, perjashtuar pak siperfaqe ne Vrepcke dhe tek Bushi i Rosoverit nga boshe ne siperfaqe me shkurre e te tjera te trajtuara ne te ardhmen si kullote me drure e shkurre.
- Kryesisht ne zonat kullosore ka tendence te ekspansionit te specieve drusore dhe shkurrore si pisha e zeze, ahu,lisi, shkoza dellinja etje. Kjo gje vrehet kryesisht ne

ngastrat 27i, 27j, 27l, 27m, 29b, 30b,30c, 33b,33c dhe 35 ku shkalla e mbulimit varjon deri ne 25 – 40 %.

- Ne zerin toke bujqesore, kullote, urbane, ujore, pothuajse nuk ka ndryshim persa i perket destinimit dhe siperfaqes.

Perdorimi actual dhe I propozuar i territorit *Tab.3.1.1.1*

Perdorimi	Aktuale		E propozuar	
	Ha	*%*	*Ha*	*%*
Pyje	1783.125	28	1783.125	28
Bujqesia	3431.8	54	3431.8	54
Kullota, livadhe	923.27	14	923.27	14
Urbane	199.25	3	199.25	3
Ujore	5.123	0	5.123	0
Te eroduara	7.472	0	7.472	0
Tetjera	49.23	1	49.23	1
Total	**6399.27**	100	**6399.27**	100



Siperfaqja e ekonomise pyjore ne total ne krahasim me mbareshtrimin e meparshem paraqet ndryshim, pasi tani ne pronesi te bashkise Maliq ngelen 2713.869 ha. Theksojme se keto ndryshime jane per efekt te ndryshimit te pronesise dhe te perdorimit te ketyre siperfaqeve. Nje pjese e madhe e fondit pyjor te kesaj ekonomie ka kaluar ne pyje privat dhe pjesa tjeter eshte ndare me bashkine Korçe.

3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Forma e qeverimit ne te cilen futen grumbujt pyjore te ekonomise Zëmblak-Mali i Thatë, sipas mbareshtrimit aktual dhe te propozuar jepet nga tabela si me poshte.

- Forma e qeverimit sipas mbareshtrimit aktual dhe te propozuar

Tab. 3.1.2.1

Perdorimi	**Aktuale**		**E propozuar**	
	Ha	*%*	*Ha*	*%*
Trungishte	207.193	12	207.193	12
Cungishte	462.511	26	462.511	26
Shkurre	1113.421	62	1113.421	62
Total	**1783.125**	100	**1783.13**	100

Sikurse shihet ne pergjithesi nuk kemi ndryshime te formes se qeverisjes se grumbujve pyjor te mbareshtrimit aktual me ate te propozuar.



Planet e hershme te mbareshtrimit te ekonomise pyjore Zëmblak-Mali i Thatë sipas funksionit i ndanin pyjet ne dy grupe: pyje me funksion prodhues dhe pyje me funksion mbrojtes, kurse pyje me funksion mbrojtes dhe prodhues(mbrojtes me mundesi prodhimi) nuk ka pasur.

Ne mbareshtrim eshte propozuar perveç pyjeve me funksion prodhues dhe funksion mbrojtes si funksione kryesore, te gjithe grumbujt pyjore do te kene dhe funksione te tjera si pyje me funksion mbrojtes me mundesi prodhimi dhe e kunderta, pra nuk do te kene vetem funksionin kryesor.

Komentet e ndryshimeve ne siperfaqe sipas funksioneve ndermjet dy mbareshtrimeve jepen me poshte:

1. Funksioni rekreativ ne kete ekonomi nuk eshte planifikuar ne menyre te veçante por nje pjese e mire e grumbujve mund te trajtohen shume mire dhe si te tille.

2. Studimi i propozuar i grumbujve te Zëmblak-Mali i Thatës, i cili respekton ruajtjen e ekuilibrit mjedisor dhe problemet social-ekonomike te zones diferencon pra 2 funksione kryesore:
    - Funksion prodhues
    - Funksion mbrojtes me mundesi prodhimi

Per te dhenat per 2 kategorite e funksioneve kryesore referoju tabeles Nr. *3.1.2.2*

Funksionet e grumbujve pyjor sipas mbareshtrimit aktual dhe te propozuar

Tab. 3.1.2.2

Perdorimi	**Aktuale**		**E propozuar**	
	Ha	*%*	*Ha*	*%*
Prodhues	855.82	48	855.82	48
Mbrojtes	927.305	52	927.305	52
Konservim	0	0	0	0
Rekreacion	0		0	
Total	**1783.125**	100	**1783.13**	100



3.1.3Ndarja e ekonomise pyjore ne ngastra dhe/ ose n /ngastra

Per ndarjen ne ngastra te teritorit te ekonomise jane mbajtur parasysh format e relievit dhe regjimi i trajtimit duke shfrytezuar per kete qellim kufij natyrore te dallueshem qarte ne teren. Ne pergjithesi eshte ruajtur ndarja,emertimi dhe numerimi i mbareshtrimit te meparshem.Madhesite e parcelave pyjore per trungishtet dhe cungishtet ndryshojne sipas formes se terrenit. Me poshte po japim disa te dhena per madhesine e parcelave pyjore:

- ✓ zona fushore deri 20 ha
- ✓ zona kodrinore deri 30 ha
- ✓ zona malore deri 50 ha

Nenngastrat jane njesi pyjore homogjene, te cilat jane diferencuar mbeshtetur ne:

- kriteretstacionale (prodhimtaria- me diference minimum njeklaseprodhimi)

- kriteret silvikulturore (origjina, forma e qeverimit, trajtimi etj.)
- vecçri te grumbujve pyjore: tipi i grumbullit, perberja llojore, klasa e moshes (diferenca 1 klase moshe e me teper), kuroredendesia (ndryshimi mbi 0.2), struktura, cilesia e origjina e grumbullit.

Ne planin e meparshem eshte perdorur harta me shkalle 1:25 000 edhe ne mbareshtrimin aktual eshte perdorur harta e shkalles 1:25 000.

Kufiri minimal per ngastrat dhe/ ose nenngastrat eshte 0.5 ha. Format e ngastrave dhe n/ngastrave te ekonomise jane ne pergjithesi te çregullta ne varesi te formave te terrenit dhe shkalles se homogjenitetit te grumbujve. Numerimi i njesive territoriale (ngastra dhe n/ngastra) eshte bere me numra arab ne drejtim te akrepave te ores duke filluar nga e majta ne te djathte e njesise se prodhimit. Per orientim çdo ngaster dhe n/ngaster eshte emertuar sipas toponimeve lokale te njohur nga popullata vendore.

Materializimi i kufive te njesise se prodhimit si dhe i ngastrave dhe n/ngastrave ne terren eshte bere duke shfrytezuar mundesite qe ka ofruar terreni si shkembinj, gure shtylla elektriku dhe duke prodhuar e vendosur shtylla artificiale druri. Kufiri ndares i ekonomise eshte shenuar me dy vija horizontale (=) me boje vaji te kuqe; kufiri ndares i ngastres me nje vije vertikale, kurse ai i n/ngastres me nje vije horizontalene te dy anet me dimensione 3 x 3 cm. Per identifikim e shpejte dhe te lehte te ngastrave dhe n/ngastrave ne gure apo shkembinj jane vendosur shenja te dubluara.

4. KUSHTET STACIONALE

4.1. Klima

Ekonomia Pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë" bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore. Studimi i klimës në këtë ekonomi është bërë duke patur për bazë të dhënat meteorologjike të regjistruara në vite.

Temperatura mesatare vjetore në ekonomi varion 8-10^{0}C, temperatura minimale absolute – 19^0 C ndërsa ajo maksimale absolute 34.2^0 C.

Këto vlera në vite të rralla kanë pësuar dhe ndryshime, si përsa i përket temperaturës minimale ashtu dhe maksimale.

Temperaturat mesatare regjistrohen në muajt mars e nëntor, ndërsa ato më të lartat në muajt korrik e gusht dhe më të ulëtat në muajt janar dhe shkurt.

Sasia e reshjeve brënda një viti varion ndërmjet 700-1200 mm dhe mesatarja arrin në rreth 1100 mm. Sasia maksimale mujore e regjistruar është 175,6 mm, në muajin nëntor, ndërsa ajo minimale është 30,5, e regjistruar në muajin korrik.

Reshjet bien në formë shiu, dëborë dhe breshëri. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në muajt nëntor-dhjetor, ndërsa më e vogël në muajt korrik-gusht.

Erërat në këtë ekonomi kanë drejtime të ndryshme, por mbizotërues janë drejtimet Lindje-Perëndim, Lindje, Jug dhe Veri, për gjatë gjithë vitit.

Gjatë muajve korrik e gusht përgjithësisht ka një periudhë thatësire prej rreth 40 ditësh.

4.2. Topografia dhe morfologjia

Territori i ekonomisë pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë" shtrihet nga lartësia 827 m deri në lartësinë 2000 m mbi nivelin e detit. Brenda këtij diapazoni lartësish janë të përhapur llojet kryesore të saj, bushi, qarri, pisha e zezë, ahu etje.

Tabela 7

Lartësia mbi nivelin e detit (m)	Sipërfaqja	
	(ha)	(%)
827-1000	304.706	11.2
1001-1250	1387.379	51.1
1251-1500	466.325	17.2
1501-1750	339.717	12.5
1751-2000	215.742	7.9
Totali	**2713.869**	100.0

4.3. Gjeologjia

Gjatë përshkrimit të ngastrave në terren, përcaktuam edhe morfologjinë, gjeologjinë, tokën, pjerrësinë, kundrejtimin, altitudën etj, të çdo nënngastre, e cila i bashkëngjitet projektit. Grumbujt pyjorë të kësaj ekonomie shtrihen në basenin ujëmbledhës të lumit të Devollit dhe në të dy anët e fushë të Maliqit , në të cilin rrjedhin prosak dhe përenj të shumtë. Të gjithë këta krijojnë një reliev tepër të larmishëm dhe me forma të çrregullta të terrenit.

Pyjet e kësaj ekonomie ndodhen kryesisht në pjerrësinë 21-50%, që përfaqëson pjerrësinë mesatare dhe zënë një sipërfaqe prej 1646.753 ha ose 60.7 % te sipërfaqes totale, ndërsa 112.713 ha ose 4.2 % ndodhen në pjerrësinë nën 0-20 %, që përfaqëson pjerrësinë e ulët dhe 954.421 ha ose 35.2 % në pjerrësinë e madhe.

Tabela 8

Pjerrësia	Sipërfaqja	
	(ha)	(%)
E vogël 0-20%	112.713	4.2
E mesme 21-50%	1646.735	60.7
E madhe 51-90%	954.421	35.2
Totali	**2713.869**	100.0

Pjesa më e madhe e territorit të ekonomisë pyjore "Zëmblak-Mali i Thatë" ka kundrejtim jug-perëndim, me një sipërfaqe 1240.766 ha ose 45.7 % të sipërfaqes totale.

Kundrejtimi lindor i sipërfaqes është më i pakët, me 57.677 ha ose 2.1 % të sipërfaqes totale.

Tabela 9

Drejtimet	**Sipërfaqja**	
	(ha)	(%)
Veri	**240.739**	8.9
Veri-lindje	**131.338**	4.8
Veri-Perendim	**256.641**	9.5
Perendim	**477.907**	17.6
Lindje	**57.677**	2.1
Jug	**240.771**	8.9
Jug-Lindje	**68.03**	2.5
Jug-Perendim	**1240.766**	45.7
Totali	**2713.869**	100.0

4.4.Tokat

Formacionet ku janë instaluar grumbujt pyjorë të ekonomisë, në masën më të madhe janë formacione gëlqerorë, të cilët zënë 53.6 % të sipërfaqes, me 1453.442 ha, ndërsa diferenca janë formacione ultra bazikë, 143.422 ha ose 5.3 %, flyshe, 2.109 ha ose 0.1 %, Argjilë 669.647 ha ose 24.7 % dhe të tjera 445.249 ose 16.4 %.

Tabela 10

Formacioni i Tokës	**Sipërfaqja**	
	(ha)	(%)
Gëlqerore	1453.442	53.6
Ultra bazikë	143.422	5.3
Flyshe	2.109	0.1
Sipas përllogaritjeve për ekonominë e marrë në studim, si biomasë në dispozicion për plotësimin e nevojave energjitike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat silvikulturore të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky plan mbarështrimi. Pra përfitohet një sasi biomase prej 858 m3 deri 906 m3/vit si mundësi vjetore shfrytëzimi.

7.1.6. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit

Ashtu si në mbarë vendin edhe në ekonominë e marrë në studim pyjet gjithnjë e më shumë po marrin rëndësi të madhe jo vetëm për lëndën drusore dhe për prodhimet jo drusore; por për ndikimin e madh të pazëvendësueshëm në sekuestrimi e karbonit: biodiversitet, shëndet, ekonomi dhe turizëm.

Pyjet janë të ndjeshëm ndaj klimës, ndryshimet klimatike do ndikojnë në dinamikën e ekosistemit. Ndryshimet e temperaturës dhe reshjeve mund të ndikojnë në suksesin e llojeve të ndryshme vendase dhe të huaja.

Drurët pyjorë të veçuar apo si pyll, kanë një potencial të madh për të rivendosur ekosistemet e degraduara, për të siguruar ushqim, produkte mjekësore dhe mallra të tjera që kontribuojnë në shëndetin e njeriut. Vetëm pyjet mundësojnë shërbime mjedisore si: mbrojtje nga rrezatimi diellor, mbrojtjen e ajrit nga ndotja, mbrojtje nga erërat dhe zhurma. Vetëm mjedisi pyjor arrin të krijojë një mikroklimë të përshtatshme për njerëzit dhe faunën, mbrojtjen e burimeve ujore dhe të pjellorisë së tokës, parandalimin e erozionit të tokës, zbutjen e ndryshimeve klimatike. Pyjet dhe drurët pyjor në mjediset urbane, konsiderohen sot si mjeti më i mirë; për të luftuar stresin e qenieve njerëzore, për të përmirësuar mirëqenien psikologjike, në proceset e shërimit me shpejtësi dhe rritje të kapacitetit mendor.

Nëpërmjet realizimit të procesit të fotosintezës, drurët dhe bimët e tjera të pyllit thithin nga ajri gazin karbonik (CO2) dhe çlirojnë oksigjen (O2). Gazi karbonik, gazi kryesor i efektit 'serrë', pra i mbingrohjes globale, jo vetëm fiksohet prej drurëve të pyllit, por njëherësh ky gaz depozitohet për një periudhë të gjatë kohe në dru (sa është jeta e drurit

me këmbë në pyll dhe për një pjesë të lëndës së drurit edhe për sa kohë akoma ajo përdoret në industri, jo për djegie), bëhet fjalë për dhjetëra e qindra vjet. Është ky arsyetimi bazë që pyllit i atribuohet vetia e sekuestrimit të karbonit.

Nëpërmjet realizimit të transpiracionit (avullimi i ujit prej gojëzave që ndodhen në pjesën e poshtme të gjetheve të drurëve) dhe intercepsionit (avullimi i ujit të reshjeve prej sipërfaqeve të gjetheve të drurëve) pylli ushqen ajrin me avuj uji.

- Kurorat e drurëve të pyllit mbajnë mbi vete një masë të konsiderueshme të pluhurit të ajrit, që me pas përcillet në tokë prej ujit të reshjeve.
- Nëpërmjet absorbimit në një masë të konsiderueshme të prej ujit të reshjeve . të oksideve të azotit, të amoniumit të cilët janë përgjegjës për krijimin e ozonit nëpërmjet një zinxhiri reaksionesh, pylli frenon krijimin e ozonit në shtresën e poshtme të troposferës, në shtresën e biosferës pra, ku ai (ozoni) si një oksidant shumë agresiv, rezulton i dëmshëm për njeriun dhe botën e gjallë në përgjithësi.
- Kurorat e drurëve të pyllit fiksojnë gjithashtu mjaft jone e atome të metaleve të rëndë, që konsiderohen lëndë toksike të rrezikshme për shëndetin e njeriut (përmenden këtu arseniku, kadmiumi, plumbi, etj), si edhe gazra si dioksidi i squfurit, etj.

Sa më sipër në ekonominë e marrë në studim për 207.19 ha trungishte, me rritje mesatare 141 m^3/vit, llogaritet të sekuestrohet rreth 6408.3 ton CO_2/vit, për 462.5 ha cungishte, me rritje mesatare 1946 m^3/vit, llogaritet të sekuestrohet 31487.1 ton CO_2/vit, për gjithë ekonominë sasia e dioksidit të karbonit të sekuestruar është 37895.4 ton.

Qeverisja	Sipërfaqia (ha)	Volumi (m3)	Rritja mesatare (m3)	Sasia e sekuestrimit CO2 mbi tokë(ton)	Sasia e sekuestrimit CO2 nën tokë(ton)	Sasia e sekuestrimit CO2 nga volumi(ton)	Sasia sekuestrimit CO2 nga rritja mesatare (ton)	Total sekuestrimit CO2 (ton)
Trungishte	207.19	3791.00	141.00	3460.47	2947.81	6178.5	229.8	6408.3
Cungishte	462.51	17761.00	1946.00	22041.00	9446.14	28377.9	3109.2	31487.1
Total	669.7	21552.00	2087.00	25501.47	12393.95	34556.4	3339.0	**37895.4**

Ky sekuestrim i kundërvihet mbi ndotjes së atmosferës me gazin karbonik të çliruar prej gjithë veprimtarive të drejtpërdrejta ose jo të njeriut mbi mjedisin.

7.2. Gjendja shëndetësore dhe fito sanitare

7.2.1. Drurët e tharë

Në ekonominë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë, vërehen në masë të pa konsiderueshme drurë të tharë sidomos në pyllëzimet artificiale me Pishë të Zezë nën influencën e faktorëve të ndryshëm natyrorë dhe subjektivë si kushtet atmosferike, shkaqe të panjohura, si dhe nga veprimtaria e pakujdesshme e njeriut.

E rëndësishme është të theksohet se ky fenomen nuk ndikon negativisht në biodeiversitet dhe gjendjen shëndetësore te grumbujve pyjorë në përgjithësi.

7.2.2. Dëmtimet e tjera

Ndër dëmtimet e tjera përmendim dëmtime të vegjetacionit në më pak se (< 6%) të sipërfaqes nga shkaqe të panjohura dhe neglizhim në përkujdesje. Duke qenë në sasi mjaft të vogla nuk kanë ndikim dhe pasoja mbi ekosistemet pyjore dhe mbarështrimin e pyjeve.

7.3. Prerjet e paligjshme

7.3.1. Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit

Në ekonominë e marrë në studim vërehet ndjeshëm dëmtimet nga prerjet e pa ligjëshme për dru zjarri, nga banorët e zonës. Ky fenomen ka ardhur duke u frenuar gradualisht dhe supozohet që nuk përbën problem për ecurinë e grumbujve pyjorë.

7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështrimin e pyjeve

Në këtë zonë pyjet përbëjnë një pasuri natyrore me vlerë dhe interes të veçantë. Për vlerat e larta të biodiversitetit si dhe të faktit që pyjet shërbejnë si një burim i mirë të ardhurash, është e domosdoshme që të bëhet një punë sqaruese me banorët vendas për pasojat e dëmshme që shkaktojnë prerjet ilegale si dhe për vlerën dhe dobinë që sjell një mbarështrim i qëndrueshëm i resurseve pyjore.

Një situatë e tillë e detyron personelin pyjor të zonës të marrë masa për një zbatim më rigoroz të ligjit të pyjeve, për bashkëpunim më të mirë me organet e Pushtetit vendor dhe popullatat lokale. Krahas sa më sipër nga Organet e Pushtetit vendor si dhe instanca më të larta Shtetërore duhet të hartohen strategji për luftimin e varfërisë dhe hapjen e fronteve të reja të punës, në mënyrë që të pakësohet presioni mbi pasurinë pyjore dhe të mos jetë vetëm ajo si burim të ardhurash.

7.4 Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave

7.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Ekonomia në territorin e saj ka sipërfaqe të konsiderueshme kullotash natyrore kryesisht verore. Ato gjenden në pjesën e sipërme të vegjetacionit në lartësi nga niveli i detit që fillon nga 850 m gjer në 1903 m në një sipërfaqe prej 923.272 ha.

Pjesa më e madhe e këtyre kullotave janë kullotat nga ish Ekonomia Kullosore Mali i Thatë të cilat shtrihen në një lartësi nga niveli i detin nga 850 m deri në 2000 m, në një sipërfaqe prej 850 ha ose 92 % të sipërfaqes kullosore të Ekonomisë Zëmblak-Mali i Thatë Pjesa tjetër e kullotave 73.272ha ose 8 % janë kullota nga ish Ekonomitë Pyjore si Zëmblak-Qarr etje

Këto kullota përdoren kryesisht për bagëtitë e imta në periudhën e Verës nga banorët e fshatrave përreth dhe pothuajse jo nga blegtorë të ardhur nga jashtë bashkisë . Banorët vendas në fakt përdorin në këtë periudhë për kullotë edhe pyjet e dushkut e bile edhe ata të ahut e të pishës. Nuk zbatohen sisteme te shfrytëzimit racional e teknik te kullotave (si në kullotat natyrore ashtu edhe në pyje) dhe te bërjes se gjethit për bagëtinë. Me tepër përdoren për kullote pyjet e dushkut qe janë me afër qendrave te banuara. Theksojmë se në 10 vitet e fundit 50% e sipërfaqes kullosore të Zëmblak-Mali i Thatë pothuajse shfrytëzohen mirë për kullotë. Ndërsa në pjesën tjetër ka kullotje të ulët ose nuk kulloten fare.

Tabela 7.4.1.1

Tipi i kullotës	Sipërfaqja	% ndaj Sip totale	% ndaj Sip totale
	ha	të Kullotave	të ekonomisë pyjore
Kullota verore	923.272	100	34
Kullota dimërore		-	-

Ndërsa në varësi të funksionit të tyre kullotat janë ndarë kullota me funksion prodhues dhe kullota me funksion mbrojtës të cilat më konkretisht janë si më poshtë:

Tabela 7.4.1.2

Tipi i kullotës	Sipërfaqja	% ndaj Sip totale	% ndaj Sip totale
	ha	të Kullotave	të ekonomisë pyjore
Kullota me funksion prodhues	855.716	92.7	31.5
Kullota me funksion mbrojtës	67.556	7.3	2.5

7.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha

Kullotat një pjesë përdoren nga popullatat që janë në brendësi dhe në afërsi të ekonomisë dhe pjesa tjetër mbetet pa kullotur. Përdorimi i saj në përgjithësi është individual por ka edhe raste të përdorimit kolektiv ose familjar.

Kullotat Verore përdoren kryesisht në periudhën e verës gjer në fund të vjeshtës, por në fakt shtegtimi i bagëtisë drejt kullotave verore fillon në muajin Maj gjer në fund të muajit Tetor (kjo në varësi të kushteve të motit shkon gjer në Nëntor). Edhe kullota në pyjet e lartë ka pothuajse këtë grafik kullote.

Kullotat zënë 34 % të sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë. Për stacionet në të cilat ato shtrihen mund të themi se janë me kapacitet mesatar gjer në të lartë.

Përveç kullotave për nevoja të blegtorisë përdoren edhe sipërfaqe të tjera pyjesh të ahut, të pishës, por më tepër ato të dushqeve në afërsi të fshatit.

7.4.3. Llojet e bagëtive

Aktualisht kullota përdoret për dele, për të trasha dhe më pak për dhi. Blegtoria e imte kullot kryesisht në sezonin veror dhe më pak në vjeshtë. Gjedhi përgjithësisht trajtohet me ushqim dhe regjim stallor në periudhën më të madhe të vitit.

7.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave

Nga të dhënat e popullatave lokale dhe të personelit pyjor të zonës prodhimi i biomasës në kullotat verore arrin në rreth 9000 - 12000 kv, pa përfshirë këtu sasinë e biomasës të mbulesës barishtore të pyjeve të pishës, ahut, (rreth 120 kv) etj. si dhe sasinë e gjethit që përgatitet nga pyjet e lisit, e cila sillet rreth 10 kv në vit.

Një përdorim më racional i kullotës, një krasitje më e lehtë e pyjeve të dëmtuara të dushkut do të risë kapacitetin e tyre në të ardhmen.

Kapaciteti real i tyre është rreth 3-5 krerë/ha për kullotat verore pra rreth 2770 - 4616 krerë, por në fakt aty kullosin në periudha të caktuara e nëngastra të caktuara një numër më i vogël bagëtish gati sa gjysma e kapacitetit.

7.4.5 Infrastruktura aktuale

Në ekonominë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë në pjesën kullosore të saj pra kullotat e Malit të Thatë nga informacioni i grumbulluar gjatë punës së grumbullimit të të dhënave të terrenit për planet e menaxhimit rezultojnë të jenë rreth 11 lera. Këto janë përdorur edhe si vepra ujëpirëse dhe ujitëse në këtë ekonomi. Në këto lera duhet të kryhet një verifikim mbi gjëndjen e tyre pasi në disa prej këtyre lerave janë dëmtuar dhe nuk mbajnë më ujë dhe duhen meremetuar.

7.4.6 Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore

Problem i mprehtë për kullotat është mbikullotja vetëm në zonat në afërsi të zonave të banuara, kurse pjesa tjetër nuk shfrytëzohet plotësisht kapaciteti kullosor i këtyre kullotave për arsye se nuk ka ngarkesë me blegtori dhe prej disa vitesh edhe kërkesa për ti përdorur këto kullota ka ardhur në rënie pasi nuk kanë ujë ujë për blegtorinë.
Kullotja në pyll është një problem pjesërisht shqetësues dhe që lidhet me sigurimin e gjeneratës së re në pyje dhe duhet realizuar sa më parë nga personeli pyjor i zonës.
Kullotja racionale dhe çlodhja e saj me sipërfaqe të kufizuara për 1-2 vjet do rriste së tepërmi kapacitetin e tyre në të ardhmen.

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë

Pyjet janë një pasuri dhe trashëgimi e çmueshme kombëtare dhe sipas Ligjit nr. 57/2020 Për Pyjet neni 12 pika 1 thuhet "Për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë **pasuri kombëtare** dhe trajtohen si të tilla. Funksioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre "pasuri kombëtare" dhe interesit publik që ato përmbushin". Në Nenin 2 të Ligjit Nr. 57/2020, Për Pyjet thuhet: "Objekti i këtij ligji përfshin rregullimin e administrimit të sektorit të pyjeve, organizimin institucional, rregullimin për përfitimet dhe shërbimet ndaj tij, për bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të angazhimeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore në interes të të gjithë shoqërisë.". Bazuar sa më sipër, si dhe sipas parimeve të mbarështrimit të qëndrueshëm e shumë funksional, është realizuar optimizimi i nevojave lokale me mundësitë/kapacitetet ekologjike. Gjatë hartimit të PMPK, u krye studimi i territorit, marrja e të dhënave, taksacioni pyjor, si dhe takime me grupe interesi me synim:

- Bashkërendim me aktorët lokalë që veprojnë në zonë edhe me dy – tre ekonomi pyjore fqinje, për të ndaluar prerjet abuzive e degradimin e pyjeve.
- Përfshirje dhe angazhim i aktorëve lokale, grave e grupeve të disavantazhuara me hartimin dhe zbatimin e PMPK.
- Mbrojtje e përmirësim të mjedisit të përbashkët.
- Reduktimi i varfërisë në zonat rurale.
- Trajnim profesional i aktorëve në pyje, në të gjitha nivelet (punëtorë, teknike, udhërrëfyes të guidave të natyrës)
- Përdorim i zhvillimit natyral të pyjeve (automatizimi biologjik)
- Rehabilitim e përmirësim i sipërfaqeve pyjore, për mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, përmirësim të peizazhit rural dhe ruajtja e biodiversitetit.
- Mirë menaxhim i qëndrueshëm e shumë funksional i pyjeve e kullotave.
- Përmirësim në përdorimin e territorit, të formës së qeverisjes, përmirësim të shkurreve, konvertim të tyre në cungishte dhe cungishteve ekzistuese në trungishte.
- Përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre në mënyrë që të përcaktohet realisht potenciali i tyre prodhues, pa dëmtuar biodiversitetin dhe problemet e mbrojtjes së mjedisit.
- Përcaktimi i rolit dhe mënyrës së përfshirjes së palëve të interesuara gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave, Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë Maliq parashikohet realizimi i ndërhyrjeve të rëndësishme që do të përmirësojnë dhe mbrojnë peisazhin siç janë ripyllëzimi me lloje endemike që mund të zhvillohen në kushte e territorit të bashkisë; zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe hartimi e miratimi i planeve të menaxhimit për to. Gjithashtu një parametër kritik është ruajtja dhe krijimi, aty ku mungojnë, të zonave ripariane të lumenjve dhe të liqeneve. Këto zona kanë rol shumëfunksional, sepse kontrollojnë flukset (komponentët ushqyes dhe sedimentet) që përmirësojnë cilësinë e ujit, mbrojnë tokën nga erozioni dhe ndotja, kontribuojnë në mbrojtjen nga përmbytjet, ndihmojnë në përmirësimin e mikroklimës dhe cilësinë e ajrit dhe funksionojnë si një habitat për faunën dhe në përgjithësi si një bio-korridor.

Peizazhi urban do të përmirësohet ndjeshëm përmes zbatimit të PPV dhe konkretisht nëpërmjet rindërtimit, krijimit të hapësirave të lira publike dhe hapësirave të gjelbra dhe mbjelljes së drurëve dekorativ përgjatë rrugëve. Përveç kësaj, edhe në sistemin natyror dhe bujqësor propozohen masa që do të kenë si rezultat shtimin e gjelbërimit:

- Ripyllëzimi në zona të veçanta të degraduara /të shpyllezuara,
- Rehabilitimi i guroreve joaktive, duke mbjellë lloje bimësh të përshtatshme, në mënyrë që hapësira të jetë në harmoni me peisazhin e saj rrethues dhe në përputhje me vlerat e tij estetike.
- Realizimi i një rripi të gjelbër perimetrik me drurë të lartë dhe përherëblertë, në mënyrë që të ketë izolim vizual nga rrugët më të afërta.
- Rikrijimi i brezave pyjorë mbrojtës për fushën e maliqit si më pjellorja në vend.

Pikat e nxehta (hot spots) më të rëndësishme për Bashkinë Maliq janë të lidhura me përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet e tokës. Masat mbrojtëse për këto fenomene janë të përshkruara qartë në PPV të bashkisë. Por për këto fenomene do të ketë masa te propozuara edhe në planin e menaxhimit të ekonomisë pyjore Zëmblak Mali i Thatë. Ndër të cilat do të përmendim masat për sensibilizimin e popullsisë lokale lidhur me rëndësinë e pyjeve në cilësinë e jetës së tyre; ndërhyrjet silvikulturore për përmirësimin dhe ripyllëzimin e ngastrave te degraduara dhe dëmtuara nga aktivitetet në kundërshtim mbrojtjen e mjedisit . Gjithashtu, propozimi konkret do te jete qe pyllëzimet dhe ripyllëzimet te projektohen për te krijuar grumbuj pyjore te përzier si me rezistent ndaj fenomeneve te siperpermendura. Nga bashkia do te mbështetet një studim për përpilimin e një harte me mundësi përditësimi për zonat kritike mjedisore për zjarret, rrëshqitjet dhe përmbytjet.

8.3. Objektivat kryesore të PMPK

Plani i Mbarështrimit të Ekonomisë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë, ka disa objektiva kryesore:

- Është synuar që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre – popullata lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj. pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve.

- Një objektiv i veçantë është plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore vetëm nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peizazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një objektiv të rëndësishëm të projektit, ku zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.
- Përfshirja e interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, harmonizimi i këtyre interesave në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të pyllit.
- Grumbullimi i informacionit të shumëfishtë, evidentimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë që ndikojnë në një mbarështim të qëndrueshëm të pyjeve. Informacionet nuk duhet të përshijnë vetëm ato pjesë që kanë të bëjnë me grumbullin pyjor, por të mundësojë vlerësimin e parametrave ekologjikë (klima etj) biologjikë (ekosistemet, biotopet, florën –faunën veçanërisht atë të kërcënuar).
- Identifikimi i masave që do të merren në të ardhmen, harmonizimin e të gjithë faktorëve veprues dhe përcaktimin e objektivave specifike që janë rezultat logjik i një mbarështrimi bashkëkohor.

8.4. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM

Objektivat specifike të ekonomisë pyjore janë:

- Evidentimi i gjendjes aktuale në tërë hapësirën e ekonomisë pyjore me anë të matjeve direkt në terren.
- Bashkëpunimi që në fazën e hartimit të PMPK me përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara
- Përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre.
- Organizimi i takimeve për diskutimin e masave që propozohen, dhe detajimin operacional të planit afat mesëm dhe afatgjatë.

8.5. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes

Mbarështrimi aktual nga ai i propozuar për sa i takon përdorimit të territorit, formës së qeverimit e funksioneve ka ndryshime.

Sipas formës së qeverisjes trungishtet dhe cungishtet nuk paraqesin ndryshime të ndjeshme midis mbarështrimeve dhe kanë pothuajse po ato raporte, trungishtet zënë 11.6% të sipërfaqes pyjore, cungishtet 25.9 %. ndërsa shkurret zënë përkatësisht 62.5 %
.

Funksionet kryesore dhe specifike të propozuar për grumbujt pyjor të kësaj ekonomie vërejmë se:

- pyjet prodhues zënë 855.82 ha ose 48 % të sipërfaqes pyjore nga1790.597 ha ose 100% të sipërfaqes pyjore që ishte në mbarështrimin e mëparshëm.
- pyje me funksion mbrojtës propozohet të jenë 934.777 ha ose 52 % nga 0 ha ose 0 % në mbarështrimin e mëparshëm. Në këtë propozim është marrë në konsideratë sipërfaqia e territorit të mbuluar me shkurre.

Për pyjet prodhues janë specifikuar pyjet për prodhim lëndë punimi dhe dru zjarri. Në pyjet mbrojtës janë diferencuar pyjet për mbrojtjen e ujrave, të tokës, të klimës dhe të habitateve të veçanta.

Të specifikuara këto funksione jepen edhe në tabelën 5.5.1, ku është përcaktuar edhe sipërfaqia për secilin funksion specifik. Ndarja sipas funksioneve të mësipërme ka motive të karakterit tekniko - shkencor dhe social. Në përputhje me objektivat që do të vendos plani i mbarështrimit do të fiksohen edhe masat për çuarjen e pyjeve drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

8.5.1. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Tipet e grumbullit, si edhe analiza e tyre jepen në Tabela Nr.5.3.1 etj., të rezultateve.

Llojet kryesore: Bushi, Ahu, Pisha e zezë, shkoza e zezë etj., vëllimi drusor në këmbë i pyjeve të Ekonomisë Zëmblak-Mali i Thatë në total është 21552 m^3, vëllimi mesatar/ha i pyjeve trungishte është 18.29 m^3/ha, Cungishte: 38.4 m^3/ha . Shkurret nuk kanë volum drusor.

Për cuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë.
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësime.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

8.5.2. Objektivat specifik silvikulturale

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjëndjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallimin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

Të dhënat për sipërfaqen dhe koston e çdo objektivi jepen në kapitujt përkatës.

8.5.3. Objektivat specifik për kullotat

Në ekonominë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë mbikullotja nuk paraqitet si problem, pasi kullotat shfrytëzohen me gjysmën e kapacitetit, përveç disa ngastra në afërsi të zonave të banuara, për të cilat do të tregohet kujdes gjatë punimeve përmirësuese, kryesisht në ngastrat e dushqeve. Tendencë në rritje kanë numri i krerëve të lopëve dhe më pak dhia.
Gjithashtu duhet të përmirësojmë ndjeshëm infrastrukturën në kullota veçanërisht në mbritshmëri dhe vepra ujëpirëse me qëllim rritjen e kapacitetit mbajtës dhe shmangjen e kullotjes së detyruar.

8.5.4. Objektivat specifik mbi biodiversitetin

Shtrirja e ekonomisë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë ,nga 827 m mbi nivelin e detit deri 2000 m mbi nivelin e detit, ekspozicioni i saj me luginat dhe shpatet e shumtë, përrenjtë, përroskat e shumta e bëjnë këtë ekonomi mjaft të larmishme nga pikpamja e biodiversitetit. Në të ardhmen lihet detyrë që të ruhet ky biodiversitet, të mbrohet dhe shtohet, me synim për ta bërë më atraktive zonën, me drejtim zhvillim agroturizmi.
Rreziqet për biodiversitetin kanë qënë dhe mbeten shfrytëzimet intensive, prerjet ilgale, mbikullotja në afërsi të fshatrave.
Për përmirësimin e biodiversitetit, të synojmë veçanërisht te llojet dhe varietetet gjenetike.

8.5.5. Objektivat specifik mbi gjëndjen shëndetësore

Vërehen dëmtime të drurëve, kryesisht nga veprimi i erës, veçanërisht në vende të eroduara, kryesisht pishat e zeza të pyllëzuara e që kanë arritur mbi 40 vjet kjo varet edhe nga kushtet e stacionit ndonëse këto nuk janë masive dhe të theksuara.
Prerjet ilegale janë problem shqetësues për të ardhmen. Për të frenuar këtë fenomen rekomandohet rritja e përgjegjësisë të personave përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve pasi ata pyje që dëmtohen për qëllime fitimi shkaktojnë pasoja të pariparueshme. Del më evident zbatimi rigoroz i ligjit, transferimi i përgjegjësive dhe kompetencave drejt bazës e deri tek përdoruesi i përditshëm. Një gjë e tillë është e parashikuar edhe në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve.

8.5.6. Objektivat specifik mbi faunën

Për mbarështrimin e gjahut objektiv kryesor për periudhën e vlefshmërisë të planit do të jetë krijimi i kushteve të përshtatëshme për ushqim, riprodhim dhe folëzim.
Pasuria faunistike mund të shëndrrohet në një bazë për zhvillimin e gjuetisë turistike në ekonomi, gjë që është në interes të gjithë komunitetit të zonës.
Ka një numur të konsiderueshëm të faunës së egër, të pranishëm janë: lepuri, thëllëza e malit, pëllumbi, mëllenja, dhelpra, ujku ariu, derri i egër, sorkadhe, etj. Gjithashtu gjenden Iriqë dhe breshka. Prania e tyre tregon për një biodiversitet të kënaqshëm. Zhvillimi i popullatave të faunës së egër ka ndikim pozitiv mbi ekosistemet pyjore dhe mbi mbarështrimin e pyjeve.

Për kafshët dhe shpendët e kërcënuara shpallja e disa parcelave si zona strikt të mbrojtura është një masë efikase në drejtim të mbrojtjes së tyre.
Kryerja e një inventari të gjahut mbi kritere tekniko-shkencore do të ndihmonte së tepërmi në monitorimin e popullatave dhe përcaktimin e gjëndjes së tyre. Me një informacion të tillë mund të merren masa të plota për mbarështrimin shkencor të gjahut.
Ndalimi i gjuetisë pa leje dhe me mjete të ndaluara gjuetie është një objektiv që kërkon seriozitet dhe këmbëngulje gjer në realizimin e tij të plotë.

8.5.7. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues

Objektivi specifik për funksionin prodhues do të jetë shfrytëzimi me prerje suksesive, sidomos i grumbujve mbi moshën e shfrytëzueshmërisë si dhe sigurimi i gjeneratës së re të pyjeve, vjelja e një sasie të konsiderueshme materiali drusor të trashë, pa cënuar vijueshmërinë e prodhimeve drusore gjatë gjithë ciklit të prodhimit (120 vjet). Mbarështrimi i qëndrueshëm i pyjeve të rinj gjer në arritjen e moshës së shfrytëzueshmërisë nëpërmjet ndërhyrjes me punime silvikulturore duke siguruar të ardhura nga pylli me sa më pak pasoja negative në mjedis. Nga ndërhyrjet me pastrime e rrallime do të diferencohen drurët me cilësi më të mirë (drurët e së ardhmes) duke siguruar një gjeneratë të re me trung të drejtë e cilindrik dhe kurorë pak a shumë simetrike. Objektivi final do të jetë krijimi i pyjeve me cilësi të lartë e të mesme për prodhim lënde punimi të trashë e të mesme.
Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje, është bërë në mënyrë spontane kur dihet se e gjithë zona përdor si burim energjie për ngrohje e gatim drutë e zjarrit.
Për këtë duhet të shfrytëzohen parcelat e përcaktuara për trajtime me prerje suksesive, ricungimet, si dhe materiali drusor që do të rezultojë nga prerjet e ndryshme silvikulturale. Do të përcaktohen detyrimisht parcela të veçanta për prodhimin e druve të zjarrit nga banorët e zonës, përveç druve të zjarrit të rezultuara nga ndërhyrjet silvikulturale apo drurët e dëmtuar nga faktorët atmosferike.
Potencialisht kjo ekonomi ka bimë mjekësore, eterovajore e tanifere që janë një potencial i sigurimit të të ardhurave të banorëve. Për këtë do të respektohen të gjitha kriteret teknike mbi mënyrën e grumbullimit të tyre me qëllim të sigurohet vazhdimësi prodhimi. Mund të përmendim frutin e Mollës së egër, Dëllinja e kuqe dhe e zezë, Trëndafili i egër, Murrizi, etj.

8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës

Për 10 vjeçarin e vlefshmërisë së planit, objektivat specifike për funksionin mbrojtës do të konsistojnë në fuqizimin e funksionit mbrojtës të pyjeve duke mos lejuar prerje e kullotje, si dhe duke organizuar një punë të pa ndërprerë propagandistike për ndërgjegjësimin e popullatës lokale për efektet mbrojtëse të pyllit ndaj tokës, klimës, ujrave dhe infrastrukturës. Kjo do të bëjë që mbrojtjen e pyjeve me këtë funksion ta marrin në dorë vetë banorët vendas, gjë që do të garantojë zbatimin e këtij objektivi.

8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni

Për realizimin e objektivave të vendosura për pyjet me funksion rekreacioni duhet në fillim të krijojmë mundesinë e zhvillimit të aktiviteteve turistike rekreative dhe çlodhëse për njerzit. Kjo gjë arrihet duke bërë prezent te mirat dhe produktet që ofrojnë pyjet e Zëmblak-Mali i Thatë tek operatorët turistik që kërkojnë të zhvillojnë të tilla aktivitete. Nga zyrat e promovimit në bashki do të prodhohen fletëpalosje dhe guida turistike si do të nxiten banorët e zonës të zhvillojnë turizmin familjar. Në këtë ekonomi pyjore nuk janë përcaktuar grumbuj pyjor me funksione specifike si rekreacioni. Megjithatë, gjendja natyrore e peisazhit dhe vegjetacioni i pyjeve të Zëmblak-Mali i Thatë ofrojnë mundësi të favorshme rekreative.

8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues

Duhet të theksojmë se funksioni konservues i pyjeve është një objektiv që kërkon një personel pyjore me kualifikim të lartë profesional pasi dhe puna që kryejnë është punë me të till nivel.

Në këta grumbuj personeli do të menaxhoi ndërhyrjet silvikulturore përsa i përket intensitetit të ndërhyrjes dhe teknikës së përdorur për zbatimin e prerjeve, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet objektivi konservues i vendosur nga plani i menaxhimit. Kërkohet korrektësi në zbatimin e ligjit për përdorimin e territorit. Po ashtu, edhe për këtë funksion specifik nuk ka grumbuj pyjor të propozuar. Ndoshta në mbarështrimin pasardhës do të mundësohen funksione specifike, pasi do të kemi gjëndje dhe kushte më të favorshme për një gjë të tillë.

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

Mundësia e shfrytëzimit përfaqëson në vetvete sasinë e materialit drusor që do të vilet çdo vit nga ekonomia në kuadrin e ciklit të prodhimit pa cënuar multifunsionet e pyllit në dobi të shoqërisë dhe vijueshmërinë e prodhimeve drusore e jo drusore.

Si rregull madhësia e kesaj kuote nuk duhet ta kalojë madhësinë e rritjes vijuese natyrore vjetore të grumbujve, kurse e kundërta mund të ndodhë në raste të veçanta kur kemi të bëjmë me pyje shumë të vjetër ku vlera e rritjes vijuese vjetore e të cilëve është shumë e vogël ose tenton zeron. (pyje mbi 160 vjet).

Sasia vjetore e prerjes do të jetë ajo që do të rezultojë nga përllogaritjet me metodat e njohura të mbarështrimit, duke i shtuar kësaj edhe sasinë e materialit drusor, që do të dali nga kryerja e punimeve silvikulturale, pastrime e rrallime, të cila në nivel ekonomie kapin shifrën rreth 477 m^3 në vit.

Mundësia e shfrytëzimit është llogaritur me metodat e njohura të mbarështrimit.

a. Metoda silvikulturale.

Kjo metodë mbështetet në kritere silvikulturale prej dhe ka marrë emrin.

Formula për llogaritjen me këtë metodë është:

$P = (V_{shf} + V_{tejshf}) / n$ ku:

P = mundësia e shfrytëzimit.

V_{shf} = vëllimi i grumbujve në moshë sa mosha e shfrytëzueshmërisë (brenda ciklit të prodhimit) m^3. (0 m^3)

V_{tejshf} = vëllimi i grumbujve mbi moshën e shfrytëzueshmërisë (0 m^3).

n = numri i viteve të periudhës (20 vjet).

b. Llogaritja e mundësisë së shfrytëzimit me anë të formulës Mason-Mantel

Llogaritja me këtë metodë bazohet në formulën: **P = 2Fr/r**

Ku: **Fr** = Fondi real i prodhimit (volumi total i ekonomisë) (21552 m^3)

r = cikli i prodhimit (120vjet)

Duke zbatuar formulat rezulton se:

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me ***Metodën silvikulturale*** është **0 m^3**.

Pra 0 m3 vilet nga grumbujt në dhe mbi moshën e shfrytëzueshmërisë dhe 477 m^3 vilet nga ndërhyrjet silvikulturore.

Mundësia vjetore e shfrytëzimit me metodën ***Mason-Mantel*** është **359.2 m^3**

Mundësia e shfrytëzimit e llogaritur me këto dy metoda siguron zhvillim të qëndrueshëm të grumbujve pyjore të ekonomisë dhe vijueshmëri prodhimi të materialit drusor, pasi ajo rezulton më e vogël se rritja vjetore e grumbujve të ekonomisë pyjore e cila është 2088m^3.

9.2. Prerja vjetore silvikulturore

Prerjet silvikulturale për ekonominë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë përfshijnë sasinë e volumit të materialit drusor që do të rezultojë nga masat e marra si trajtime silvikulturore për çdo vit brënda planifikimit dhjetë vjeçar, të cilat janë si më poshtë vijon:

Tabela 9.2.1

Viti	Ngastra	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip. që do ndërhyet (ha)	Volumi materialit (m3)	Intensiteti (%)	Shënim
2024	1b	Rallime Parakomerciale	3.709	19	25	
2024	1c	Rallime Parakomerciale	4.567	23	25	
2023	3a	Rallime Parakomerciale	17.808	246	20	
2023	3b	Rallime Parakomerciale	30.927	482	20	
2023	4a	Rallime Parakomerciale	44.250	1805	30	
2023	5b	Rallime Parakomerciale	5.946	94	20	
2023	6	Rallime Parakomerciale	13.095	522	30	
2023	7a	Rallime Parakomerciale	52.388	786	30	
2026	9a	Rallime Parakomerciale	15.722	145	25	
2026	10a	Rallime Parakomerciale	25.904	175	25	
2025	12a	Rallime Parakomerciale	26.012	104	25	
2022	13a	Rallime Komerciale	20.010	123	15	
2023	14b	Rallime Parakomerciale	4.995	12	20	
2027	22a	Rallime Komerciale	8.712	45	20	
2027	22b	Rallime Parakomerciale	18.751	173	25	
2023	24c	Rallime Parakomerciale	3.608	14	20	
Totali			296.404	4770		

Tabela 9.2.2

Viti	Ngastra	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip. që do ndërhyet (ha)	Shënim
2023	2b	Pastrime	6.150	Shkure
2022	5c	Pastrime	5.389	Shkure
2022	9b	Pastrime	4.605	Shkure
2027	55a	Ricungim	60.372	Shkure
2027	56a	Ricungim	21.670	Shkure
2026	57c	Ricungim	14.560	Shkure
Totali			112.746	

9.3. Planifikimi vjetor i masave

9.3. 1 Masat në Pyje

Prerjet silvikulturale për ekonominë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë përfshijnë sasinë e volumit të materialit drusor që do të rezultojë nga masat e marra si trajtime silvikulturore për çdo vit brenda planifikimit dhjetë vjeçar. Në këtë ekonomi pyjorë është parashikuar të ndërhyet me prerje parakomerciale dhe komerciale. Sasia e materialit drusor që rezulton nga shfrytëzimet është pothuajse e njëjtë me atë të rezultuar nga rrallimet. Kjo gjë tregon se grumbujt pyjore janë në pjesën dërmuese janë në moshë të re. Masat silvikulturore janë si më poshtë vijon:

Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve – Pyje *Tab.9.3.1.1*

Viti	Ngastra	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip. që do ndërhyet (ha)	Volumi materialit (m3)	Intensiteti (%)	Shënim
2024	1b	Rallime Parakomerciale	3.709	19	25	
2024	1c	Rallime Parakomerciale	4.567	23	25	
2023	3a	Rallime Parakomerciale	17.808	246	20	
2023	3b	Rallime Parakomerciale	30.927	482	20	
2023	4a	Rallime Parakomerciale	44.250	1805	30	
2023	5b	Rallime Parakomerciale	5.946	94	20	
2023	6	Rallime Parakomerciale	13.095	522	30	
2023	7a	Rallime Parakomerciale	52.388	786	30	
2026	9a	Rallime Parakomerciale	15.722	145	25	
2026	10a	Rallime Parakomerciale	25.904	175	25	
2025	12a	Rallime Parakomerciale	26.012	104	25	
2022	13a	Rallime Komerciale	20.010	123	15	
2023	14b	Rallime Parakomerciale	4.995	12	20	
2027	22a	Rallime Komerciale	8.712	45	20	
2027	22b	Rallime Parakomerciale	18.751	173	25	
2023	24c	Rallime Parakomerciale	3.608	14	20	
Totali			296.404	4770		

9.3.2 Masat në kullota

Për përmirësimin e kullotës është parashikuar që të bëhet luftimi i bimëve të pangrënëshme e të helmëta si dhe i shkurreve e shkurrëzave, heqje gurësh të lëvizshëm, plehërim me vathim. Njëkohësisht është parashikuar rikonstruksioni i lerave ekzistuese dhe ndërtim i lerave të reja dhe ngrehinave.

Do të merren masa për të evituar mbingarkesën në kafshë, për të shfrytëzuar racionalisht kullotën. Për këtë do të bëhet punë këshilluese me banorët vendas.

Plani vjetor i nderhyrjeve – Kullota *Tab.9.3.2.1*

Viti	Ngastra	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip. që do ndërhyet (ha)	Shënim

2022	1d	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	1.453	Kullotë
2022	1e	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	2.481	Kullotë
2022	2c	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	3.043	Kullotë
2021	3c	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	7.506	Kullotë
2021	3d	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	3.664	Kullotë
2025	5d	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	3.119	Kullotë
2025	7b	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	1.616	Kullotë
2021	16c	Pastrim guresh te levizshem	15.204	Kullotë
2024	24g	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	1.396	Kullotë
2024	25b	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	1.767	Kullotë
2024	25c	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	3.311	Kullotë
2021	41b	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	12.774	Kullotë
2021	46b	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	25.303	Kullotë
2022	50	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	63.792	Kullotë
2022	51	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	77.413	Kullotë
2022	52	Pastrim shkuresh dhe bimesh te pa deshiruara	43.225	Kullotë
Totali			267.067	

9.3.3 Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

Përsa i përket kësaj çështje mund të theksojmë se nuk ka asnjë masë të propozuar pasi nuk ka grumbuj pyjor me funksion rekreative në këtë ekonomi. Për këtë qëllim ka mungesë jo vetëm të kushteve por edhe të personelit të kualifikuar. Mendojmë se është çështje që do ti kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt.

9.4. Masat afat-gjata

9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

a - masa për favorizimin/stimulimin e rigjenerimit natyror në siperfaqet me bimësi pyjore me kurordendësi nën 30%

Përsa i përket ekonomisë pyjore Zëmblak-Mali i Thatë mund të themi se ngastrat dhe nëngastrat e shrytëzuara kanë një ripërtëritje të mirë dhe për këtë arsye është e nevojshme të ndërhyet me trajtime silvikulturore.

b - trajtime silvikulturore:

Pastrimet do të kryhen në shkure dhe do të plotësojnë disa qëllime dhe objektiva si në drejtim të rregullimit të strukturës, seleksionimit të drurëve të së ardhmes si dhe aktivizimit të rritjes. Ato do të shtrihen në një sipërfaqe prej 16.144 ha. Koha më e mirë për kryerjen e tyre është periudha e pushimit të vegjetacionit . Punimet do të kryhen nga firma private të specializuara për punime në pyje. Prerjet silvikulturore pastrime do të kryhen me krah pra nuk do të planifikojmë ndërhyrje të mekanizuara pavarësisht se mekanizimi tenton të ulë kostot, kjo për faktin se kostoja e krahut të punës është e ulët. Kurorë dendësia e grumbullit nuk duhet të zbresë asnjë herë nën 0.8.

Rrallimet parakomerciale do të kryhen në grumbujt e etapës së rinisë, në fazën e lëmishtës, imështajës se re dhe të moçme me moshë nga 20 – 40 vjet. Intensiteti rrallimit do të jetë nga 15 – 30 % të numurit të drureve dhe do të jenë të urgjencës 1, 2 dhe 3. Rrallimet parakomerciale do të kryhen në **267.682** ha, do të nxirret një volum prej **4602 m^3** material drusor kryesisht dru zjarri dhe një pjesë shumë e vogël lëndë. Punimet do të kryhen nga firma vendase me mjete krahu të mekanizuara.

Ndërsa rrallimet komerciale do të kryhen në fazën e imshajës së moçme dhe trungishtes së re dhe të mesme në një sipërfaqe prej **28.722 ha** dhe do të nxirret një volum prej **168 m^3**. Në këto rrallime duhet të përdoren mjete të mekanizuara si për prerjen dhe transportin e lëndës drusore. Gjithashtu, në zbatimin e operacioneve të rrallimit komercial duhet ti kushtohet vëmendje e madhe përzgjedhjes së drurëve të prodhimit përfundimtar. Ndërsa ricungimet do te kryhen ne shkure me një sipërfaqe prej 96.602 ha dhe nuk ka materjal drusor.

Tab. 9.4.1.1

Nr.	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sipërfaqia (ha)	Volumi (m3)	Shpenzimet (lekë)		
				Për 1 ha	Për m3	Gjithsej
1	Ricungime	96.602		45000		4347090
2	Pastrime	16.144		45000		726480
3	Rrallime Parakomerciale	267.682	4601	50000	2908.95	13384100
4	Rallime Komerciale	28.722	168	60000	10257.9	1723320
5	Totali					20180990

c - masa të tjera:

Në pyjet halor të Zëmblak-Mali i Thatë për të luftuar procesionaren e pishës dhe vemjen e dushqeve do të ishte mirë që të aplikohej lufta biologjike me kalosomën. Ky insekt dobiprurës është eksperimentuar me shumë sukses nga Fakulteti i Shkencave Pyjore me mbështetje të Qeveris Turke. Ministria përgjegjëse duhet të mbështes këtë mënyrë luftimi të dëmtuesëve pasi është një investim afatgjatë dhe tepër miqësor me mjedisin.

9.4.2. Masat silvikulturore në Trungishte

Trungishtet në të cilat do të cilat do të kryhen ndërhyrje janë 20.596 ha me një volum materjali drusor prej 101 m3

Tabela 9.4.2.1

Viti	Ngastra	Sipërfaqia	Klasa e moshes	Qeverisja	Masat	Intensiteti	Vol (m3)
2024	1b	3.709	1	Trungishte	Rallime Parakomerciale	25	19
2024	1c	4.567	1	Trungishte	Rallime Parakomerciale	25	23
2027	22a	8.712	3	Trungishte	Rallime Komerciale	20	45
2023	24c	3.608	1	Trungishte	Rallime Parakomerciale	20	14
Totali		20.596					101

9.4.3. Masat silvikulturore në cungishte

Cungishtet në të cilën do të kryhen ndërhyrje shtrihen në 275.808 ha sipërfaqe dhe me një volum 4669 m3 janë në gjëndje të mirë dhe mesatare. Një pjesë e tyre janë afër fshatrave . Ndërhyrjet për të siguruar lëndën drusore për nevojat personale realizojnë trajtime selektive të pjesëshme të grumbujve pyjor. Masat silvikulturore në cungishte do të kryhen si më poshtë

Viti	Ngastra	Sipërfaqia	Klasa e moshes	Qeverisja	Masat	Intensiteti	Vol (m3)
2023	3a	17.808	1	Cungishte	Rallime Parakomerciale	20	246
2023	3b	30.927	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	20	482
2023	4a	44.250	1	Cungishte	Rallime Parakomerciale	30	1805
2023	5b	5.946	1	Cungishte	Rallime Parakomerciale	20	94
2023	6	13.095	1	Cungishte	Rallime Parakomerciale	30	522
2023	7a	52.388	1	Cungishte	Rallime Parakomerciale	30	786
2026	9a	15.722	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	25	145
2026	10a	25.904	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	25	175
2025	12a	26.012	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	25	104
2022	13a	20.010	4	Cungishte	Rallime Komerciale	15	123
2023	14b	4.995	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	20	12
2027	22b	18.751	2	Cungishte	Rallime Parakomerciale	25	173
Totali		275.808					4669

- konvertimi i cungishtes në trungishte

Konvertimi i cungishteve në trungishte është një nga masat afatgjata për ndërhyrjet në silvikulturën e cungishteve. Për të realizuar këtë ndërhyrje duhen shumë përpjekje të cilat në kushtet e ekonomisë pyjore Zëmblak-Mali I Thatë nuk janë efikase për momentin. Grumbujt pyjor të trajtuara si cungishte kanë avantazhin se japin prdukte pyjore drusore dhe jo drusore jo vetëm në kohë të shkurtër por edhe në sasi të kënaqëshme. Sot në vëndet e zhvilluara të Europës pyjet cungishte kanë marrë një vëmendje të veçantë, pasi prduktet e tyre drusore përdoren shumë për prodhimin e bioenergjisë. Konkretisht mendoj se cungishtet e Zëmblak-Mali I Thatë duhen trajtuar si të tilla pasi ato përdoren jo vetëm për prodhimin e druve të zjarrit nga banorët e njësisë administrative por është si bazë ushqimore për blegtorinë. Personeli pyjor duhet të organizoj trajnime me banorët e njësisë për mënyrën dhe teknikat silvikulturore të vjeljes së gjethit.

9.4.4. Masat silvikulturore në shkurre

Janë parashikuar masa në shkurre pastrime dhe ricungime, ato nuk kanë volum por duhet të trajtohen pasi ne këto parcela mund të përfitojme cungishte të mira.

Tabela 9.4.4

Viti	Ngastra	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sip. që do ndërhyet (ha)	Shënim
2023	2b	Pastrime	6.150	Shkure
2022	5c	Pastrime	5.389	Shkure
2022	9b	Pastrime	4.605	Shkure
2027	55a	Ricungim	60.372	Shkure
2027	56a	Ricungim	21.670	Shkure
